

Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **27.04.2023** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: "*Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe te folmet turke në Kumanovë me rrethinë*", të kandidatit **Mr. Eljesa Ismailovski**.

Në bazë të vendimit **16-216/2** të datës **27.04.2023**, Komision i përbërë nga: **Prof.dr. Abdulla Hamiti** (kryetar), **Prof.dr. Nazim Ibrahim**, **Prof.dr. Osman Emin**, **Prof.dr. Ziber Lata** (anëtarë) dhe **Prof.dr. Sulejman Baki** (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

RAPORT

për vlerësimin e punimit të doktoraturës

Të dhëna biografike për kandidatin

Kandidati **Mr. Eljesa Ismailovsk** është lindur më 29 gusht të vitit 1972 në Kumanovë. Shkollën fillore e ka kryer në "*Jane Sandanski*"- Shkup (1980-1988), kurse të mesme e ka kryer në Medresenë "*Isa Beu*"- Shkup (1988-1992). Studimet deridiplomike ki ka kryer në Universitetin e Ankarasë (Turqi), në Fakultetin Teologjik (1995-2000). Në vitin akademik 2016 ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve në Institutin e Historisë Nacionale- Shkup, me temë të magjistraturës: "*Veçoritë e sistemit administrativ osman me theks të veçantë në Maqedoni (shek. XVI-XVIII)*". Në vitin akademik 2020/2021 ka regjistruar studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Shkenca mbi gjuhën, drejtimi: Filologji orientale, dhe është në fazën e mbrojtjes së temës së disertacionit me titull "*Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe te folmet turke në Kumanovë me rrethinë*". Gjatë periudhës së viteve 2009-2015 ka punuar si mësimdhënës në Medresenë "*Isa Beu*"- Shkup. Nga viti akademik 2014/2015, kandidati **Mr. Eljesa Ismailovski** ;sht; i angazhuar si asistent në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor: Filologji orientale.

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoraturës

Kandidati me sukses ka realizuar tre konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Mr. Eljesa Ismailovski gjatë studimeve të doktoraturës ka botuar dy punime shkencore, që janë të lidhura drejtpërdrejt me temën e doktoraturës.

1. 2022 – Studime Albanologjike 22, *Struktura e veprës së Fuzuliut “Lejla dhe Mexhnun” dhe estetika e të shprehurit* ISSN: 1857-6958 (Print).
2. 2021- VIZIONE, nr. 36, *Lejla e Mehmet Akif Ersojit*, ISSN: 1409-8962 (Print), ISSN: 1857-9221 (Online).

Analizë të punimittë doktoraturës

Punimi i doktoraturës “*Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe te folmet turke në Kumanovë me rrethinë*”, është ndarë, në: Hyrje, katër kapituj, Përfundimi dhe Literaturën e shfrytëzuar. Punimi është shkruar në 275 faqe, me 107 njësi bibliografike, me fond të shkronjave Times New Roman, madhësi 12 dhe largësi 1.5.

Në hyrje kandidati ka dhënë arsyetueshmerinë dhe ecurinë e temës si dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore që ka ndjekur gjatë punimit të këtij disertacioni të doktoraturës.

Marrëdhënia e turqishtes me gjuhët e Ballkanit dhe veçanërisht me shqipen, e cila konsiderohet një nga gjuhët më të vjetra në gjeografinë e Ballkanit, dhe për këtë arsye ndërveprimi dhe lidhja e saj, ka tërhequr vëmendjen e shumë gjuhëtarëve të vendit dhe të huaj. Marrëdhëniet gjuhësore midis komuniteteve kanë qenë objekt studimi i shumë shkencëtarëve.

Gjuhët zhvillohen nga dy faktorë kryesorë; E para janë faktorët e zhvillimit brenda gjuhës ose mendimi i brendshëm ose drejtimi i gjuhës, siç theksojnë gjuhëtarët. E dyta është faktorët jo-gjuhësorë; Këto kanë të bëjnë me arsye të rëndësishme intra-gjuhësore në periudhat historike dhe bashkëkohore të gjuhës, duke u lidhur me gjuhë të tjera, duke marrë modele fjalë dhe leksikore nga ato gjuhë, për të shprehur njësi të reja gjuhësore ose për të përdorur fjalorin e gjuhëve të tjera për të dalluar dhe emëruar konceptet ekzistuese, morfema themelore dhe ndihmëse.

Turqishtja ka qenë shumë ndikuese në fonetikën, morfologjinë, sintaksën dhe semantikën e shqipes, d.m.th., në çdo degë të gramatikës. Fjalët e terminologjisë fetare islame, përveç se në komunikimin e përditshëm brenda shqiptarëve muslimanë, janë përfshirë edhe në veprat letrare si elementë me shumë fuqi stilistike si metafora. Gjuha shqipe nuk ka një strukturë gjuhësore për të zëvendësuar idiomat dhe shprehjet tona që kemi krijuar me këto fjalë.

Në kapitullin e parë, *ZHVILLIMI I GJUHËS TURKE DHE KULTURËS NË BALLKAN*, janë trajtuar disa çështje të rëndësishme kryesisht jo-gjuhësore por historike dhe të historisë së gjuhës, respektivisht prezencës së gjuhës turke në Ballkan, historikut të depërtimit të saj, marrëdhënieve të saja me gjuhën shqipe si dhe mbijetesat huazimeve nga turqishtja në gjuhën e sotme standarte shqipe.

Disa nga temat e trajtuara në kapitullin e parë janë: *Një përmbledhje e shkurtër e përhapjes dhe zgjerimit të turqve në gjeografinë ballkanike, Gjuhët ballkanike dhe marrëdhëniet me gjuhën turke, Marrëdhëniet gjuhësore turko-shqiptare, Elementet e gjuhës turke në gjuhën shqipe, Reflektime të gjuhës dhe kulturës turke te shqiptarët, Marrëdhënia e huazimit midis turqishtes dhe shqipes, Marrëdhëniet e huazimeve midis shqipes dhe turqishtes sipas modeleve të bashkëveprimit kulturor.*

Bashkëjetesa e shqiptarëve, e cila vjen nga fakti se shumica e tyre kanë të njëjtën fe me turqit, ka sjellë një rritje të shpejtë të numrit të fjalëve huazime turke në gjuhën shqipe. Në këtë periudhë filluan të përdoren shumë fjalë turke që lidhen me kulturën bazë dhe jetën shoqërore si profesioni, koncepti, personi, farefisi, ushqimi dhe veshja.

Kronologjia e fjalëve të bartura nga turqishtja në gjuhën shqipe mund të shqyrtohet vetëm duke ndjekur rrethanat politike, shoqërore dhe kulturore të Perandorisë Osmane. Depërtimi më i hovshëm dhe më masiv i bartjes së fjalëve turke në gjuhën shqipe ka qenë periudha e shek. XVIII- XIX, kur gjuha turke nuk ishte vetëm huazuese por edhe bartëse e fjalëve kryesisht orientale, prandaj nuk është rastësi që sot referimi ynë për arabizmat dhe persizma si turqizma.

Hapësira shqiptare ishte pjesë e Perandorinë Osmane për gjashtë shekuj. Në një rast të tillë, është e pashmangshme që kultura turke të jetë efektive këtu dhe jo në të gjitha vendet e tjera të Ballkanit. Ky ndikim jo vetëm që kontribuoi në fushën e gjuhës, fesë, kulturës arkitekturore, por kontribuoi edhe në krijimin e veprave letrare nga shqiptarët dhe u krijua një letërsi shqiptare vërtetë e pasur kombëtare.

Në pjesën e parë jepen zhvillimi i gjuhës dhe kulturës turke, zgjerimi dhe zhvillimi i gjeografisë ballkanike, raportet e gjuhëve ballkanike me turqishten dhe veçanërisht veçoritë gramatikore ndërmjet interesit turk dhe atij shqiptar. Ka pasur elemente turke që kanë kaluar në gjuhën shqipe, me fuqinë e ndikimit të gjuhës turke dhe tipare të forta derivuese e ndërthurëse.

Shpjegohen me shembuj fjalët e formuara nga rrënja turke dhe prapashtesa shqipe dhe fjalët e përbëra.

Marrëdhënia e huamarrjes lind nga fakti se ekziston një lidhje e ngushtë midis gjuhës dhe kulturës dhe pasqyrimin të gjuhës dhe kulturës turke te populli shqiptar. Sepse shkëmbyen gjuhësisht me gjuhët dhe shkëmbyen fjalë nga njëri-tjetri. Në kuadrin e studimit, raportet midis komuniteteve turke dhe komuniteteve shqiptare, huazimet midis ndërveprimit shqiptar dhe turk dhe ndërveprimi kulturor, kultura social-ekonomike e mirëqenies, kultura e profesioneve, kultura familjare dhe farefisnore etj. Duket se ka sjellë edhe modele.

Në këtë mënyrë mund të thuhet se mijëra fjalë kaluan nga turqishtja në shqipe në fund të shekullit të 18-të dhe në fillim të shekullit të 19-të, pas shumë turqizmimeve që kishin depërtuar në gjuhën shqipe në shekujt e mëparshëm. Është regjistruar se numri i huazimeve të transferuara në shqip nëpërmjet turqishtes është rreth 4500.

Kandidati për analizën dhe krahasimin e fjalëve turke dhe shqipe dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën në rajonin e Kumanovës me rrethinë është përcaktuar që të japë ndaras vetitë tipologjike të gjuhës turke dhe gjuhës shqipe, ku lehtësisht mund të vërehen si pikëtakimet ashtu edhe divergjencat në mes dy gjuhëve të cilat pavarësisht marrëdhënieve dhe huazimeve, ju takojnë dy familjeve të ndryshme gjuhësore, gjuha shqipe familjes indoevropiane kurse gjuha turke i takon familjes së gjuhëve uralo-altaje.

Në kapitullin e dytë me titull, VETITË TIPOLOGJIKE TË TURQISHTES, disa nga temat e trajtuara në kapitullin e parë janë: *Inventari fonologjik i turqishtes, Harmonia e zanorëve, Harmonia e bashkëtingëlloreve, Karakteristikat morfologjike, Radhitja e fjalëve*, ku ka bërë dy nëndarje: *Sekuena e fjalëve në togfjalëshin mbiemëror dhe Formimi i fjalëve në togfjalëshin emëror, Kategoria e kohës*, ku janë veçuar dy kategori: *Koha e tashme e çastit dhe Koha e tashme e gjerë*, kurse çështja e fundit që është trajtuar në këtë kapitull është *Folje jo e plotë imek*.

Disa nga temat e trajtuara në kapitullin e tretë, VETITË TIPOLOGJIKE TË SHQIPES, janë: *Inventari fonologjik i shqipes, Kategoria e gjinisë, Kategoria e lakimit*, ku ndaras janë trajtuar të gjitha pesë rasat në gjuhën shqipe, *Rasa emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rasa rrjedhore*. Edhe në gjuhën shqipe te *Kategoria e kohës*, janë dhenë dy ndarjet *Koha e tashme/e gjerë dhe Koha e shkuar e përcaktuar/Koha e shkuar e papërcaktuar*, në fund për krahasim është dhenë edhe modeli shqip i *Foljes jo e plotë imek*.

Kapitulli i katërt, NDIKIMI I GJUHËS TURKE NË TË FOLMET SHQIPE NË RAJONIN E KUMANOVËS, paraqet bërthamen dhe pjesën kresore të këtij punimi të doktoraturës. Është për tu theksuar se kandidati ka bërë një punë të admirueshme në terren, e cila ka nxjerrë rezultate origjinale, të dhëna të reja dhe shumë të rëndësishme për të folmet turke në Kumanovë.

Kapitulli i katërt është pjesa më e madhe e studimit sepse huazimet turko-lindore në gjuhën shqipe kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e gjuhëtarëve vendas dhe të huaj. Në pjesën e sipërpërmendur u vlerësuan karakteristikat e trevës së dialektit të Rumelit dhe u ndoq një rrjedhë nga e përgjithshme në atë specifike.

Në veçanti, nuk ka pasur kërkime në vend për turqizmat dhe te folmet turke dhe te folmen shqipe të rajonit të Kumanovës dhe rrethinave të saj. Në titullin ku trajtohen turqizmat, janë vlerësuar turqizmat e përdorura në të gjitha fshatrat e komunës së Likovës, veçanërisht në Kumanovë dhe fshatrat përreth saj, ku në përgjithësi jetojnë shqiptarë në rajonet e Maqedonisë së Veriut. Lidhur me dialektet turke të qytetit të Kumanovës, J. Eckmann mblodhi materialin e dialektit turk të folur në Kumanovë nga një emigrant i vjetër që kishte emigruar në Turqi në atë kohë dhe u përpoq të vlerësonte dialektet origjinale të përdorura sot duke treguar referenca për artikullin. që ka mbijetuar deri në ditët e sotme.

Disa nga temat e trajtuara në kapitullin e katërt janë: *Një pasqyrë e shkurtër e të folmeve turke në Kumanovë*, duke njohur rëndësinë e përdorimit të prapashtesave në gjuhën turke, kandidati në detaje dhe me shumë kompetencë jep një pasqyrë dhe bënë analizë të katër llojeve të prapashtesave, edhe atë *Prapashtesat fjalëformuese në të folmet turke në Kumanovë*, *Prapashtesat foljore në të folmet turke në Kumanovë*, *Prapashtesat që formojnë folje nga emra në të folmet turke në Kumanovë*, *Prapashtesat që formojnë folje nga foljet në të folmet turke në Kumanovë*.

Në tre nëntitujt e fundit të kapitullit të katërt, kandidati ka bërë një analizë gjuhësore për gjendjen e te folmeve turke në Kumanovë dhe rrethinë dhe ndikimin e saj në gjuhën shqipe. Të dhënat kandidati i ka argumentuar përmes fjalorëve të gjuhës turke dhe shqipe si dhe ka dhenë shembuj konkretë duke ju referuar literaturës relevante. Analiza dhe interesimi i kandidatit ka qënë sidomos fshati Gllgë, ku është realizuar edhe shumica e hulumtimit në terren e këtij punimi të doktoraturës.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Gjatë hartimit të punimit të doktoraturës me titull "*Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe te folmet turke në Kumanovë me rrethinë*", kandidati është mbështetur dhe ka respektuar teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore.

Kandidati për përgatitjen e punimit ka shfrytëzuar kryesisht fjalorë njëgjuhësh (shqip, turqisht), fjalor dygjuhësh (shqip- turqisht- shqip, maqedonisht-turqisht-maqedonisht), monografi, punime shkencore nga revista të ndryshme filologjike në gjuhën turke, shqipe, boshnjake, literaturë të përgjithshme kryesisht në gjuhën turke, shqipe, boshnjake dhe gjermane.

Njohja e gjuhës turke në nivel të lartë dhe përvoja e gjatë e kandidatit si mësimdhënës dhe studiues në terren ka mundësuar që ky punim i doktoraturës ti arrij pritshmeritë për të sjellur njohuri të reja dhe burimore për ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe në përgjithësi dhe te folmet turke në Kumanovë me rrethinë në veçanti.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Tema e doktoraturës "*Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe te folmet turke në Kumanovë me rrethinë*", është një përpjekje serioze për një punim monografik përmbledhës për të pasqyruar fondin e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës me theks të veçantë paleografinë dhe gjuhën diplomatike të tyre.

Nga ky studim kandidati nxjerr përfundimin se, turqishtja ka qenë shumë ndikuese në fonetikën, morfologjinë, sintaksën dhe semantikën e shqipes, d.m.th., në çdo degë të gramatikës. Fjalët e terminologjisë fetare islame, përveç se në komunkimin e përditshëm brënda shqiptarëve muslimanë, janë përfshirë edhe në veprat letrare si elementë me shumë fuqi stilistike, pasi gjuha shqipe nuk ka një strukturë gjuhësore për të zëvendësuar këto idiomat dhe shprehje.

Kandidati me sukses ka ndjekur dhe analizuar kronologjinë e fjalëve të bartura nga turqishtja në gjuhën shqipe. Kandidati për analizën dhe krahasimin e fjalëve turke dhe shqipe dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën në rajonin e Kumanovës me rrethinë është përcaktuar që të japë ndaras vetitë tipologjike të gjuhës turke dhe gjuhës shqipe.

Është për tu theksuar se kandidati ka bërë një punë të admirueshme në terren, e cila ka nxjerrë rezultate origjinale, të dhëna të reja dhe shumë të rëndësishme për të folmet turke në Kumanovë. Analiza dhe interesimi i kandidatit ka qënë sidomos fshati Gllëgë, ku është realizuar edhe shumica e hulumtimit në terren e këtij punimi të doktoraturës.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit në punimin e doktoraturës

Disa nga tematikat e kësaj teme mund të jenë trajtuar nga studiues në punime shkencore të ndryshme, por rëndësia e këtij disertacioni është transkriptimi, përkthimi dhe analiza e paleografisë dhe gjuhës diplomatike të të gjitha llojeve të dokumenteve në gjuhën osmane që ruhen në Arkivin e Kosovës.

Përmes shfrytëzimit të fjalorëve njëgjuhësh (shqip, turqisht), fjalorëve dygjuhësh (shqip-turqisht- shqip, maqedonisht-turqisht-maqedonisht), monografive, punime shkencore nga revista të ndryshme filologjike në gjuhën turke, shqipe, boshnjake, literaturës së përgjithshme kryesisht në gjuhën turke, shqipe, boshnjake dhe gjermane, kandidati ka sjellë prurje të reja shkencore, të cilat janë një kontribut sa modest, po aq i çmuar në fushën e filologjisë dhe me theks të veçantë për studimet e raporteve dhe ndikimeve gjuhësore të gjuhës shqipe me turqishten.

Rëndësi të veçantë nga të gjitha çështjet të cilat i ka shqyrtuar kandidati i ka kushtuar prezencës së huazimeve turke, adaptimin e tyre në fjalorin dhe gramatikën e gjuhës shqipe. Kandidati për shumicën e fjalëve ka dhënë kuptimin etimologjik, formën origjinale si dhe ndryshimet që ka pësuar jo vetëm në strukturën gramatikore por edhe në kuptimin e saj.

Si përfundim, vlerësojmë se kjo temë e disertacionit paraqet një kontribut të rëndësishëm jo vetëm filologjik por edhe në fusha tjera të përafërta, pasi mundëson pasqyrimin e ndikimeve të gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe të folmet turke në Kumanovë me rrethinë.

Hulumtime të mundshme të ardhshme

Tema e doktoraturës “*Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe të folmet turke në Kumanovë me rrethinë*”, është temë e përgjithshme dhe brënda saj janë trajtuar tematika të ndryshme, kjo krijon mundësi për të qënë një bazë e mirë për hulumtime të ardhshme.






Vlerësojmë se punimet e këtilla janë me interes për filologjinë shqiptare në përgjithësi dhe filologjinë orientale në veçanti, pasi ka për fokus ndikimin e një gjuhë të huaj për nga trungu, pasi turqishtja nuk është gjuhë indoevropiane por që për shkak të rrethanave të caktuar historike të kohës dhe për realitetin shqiptar të sotëm ka një ndikim të madh, shumica e atyre që i quajmë turqizma apo orientalizma jo vetëm që janë bërë pjesë e fjalorit por janë pjesë e pandashme dhe e rëndësishme e komunikimit të përditshëm brënda shqiptar.

Vlerësojmë se tema të këtilla në hapësirën shqiptare janë të pakta dhe si rrjedhojë pak të njohura dhe mund të shërbejnë për zgjerimin dhe thellimin e studimeve të ardhshme.

Vlerësim dhe rekomandim

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturës “*Ndikimi i gjuhës turke në gjuhën shqipe dhe të folmet turke në Kumanovë dhe rrethinë*” të kandidatës **Mr. Eljesa Ismailovski**, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit mësimor –shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni recenzues:

1. Prof. Dr. Abdulla Hamiti (Kryetar) 
2. Prof. Dr. Nazim Ibrahim (anëtar) 
3. Prof. Dr. Osman Emin (anëtar) 
4. Prof. Dr. Ziber Lata (anëtar) 
5. Prof. Dr. Sulejman Baki (mentor) 

Tetovë, 22.06.2023